

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT PËR VITIN 2023

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke vlerësuar rolin e Autoritetit në përmbushje të misionit të tij për dhënien e informacionit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, në mënyrë që të edukojë publikun e të mbështesë vlerat demokratike të drejtësisë, të vërtetën, pajtimin e përgjegjësinë për brezat e ardhshëm;

Duke konsideruar se veprimtaria e Autoritetit është udhëhequr nga parimi i ligjshmërisë, mbrojtjes së të dhënave personale, dhënies së informacionit publikut, institucioneve dhe medias në kohë dhe me cilësi;

Duke vlerësuar bashkëpunimin e Autoritetit me institucione të tjera vendase dhe institucione homologe ndërkombëtare për shkëmbimin e informacionit e të përvojës lidhur me objektin e punës së Autoritetit,

Vlerëson veprimtarinë e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit për vitin 2023 në drejtim të:

Zhvillimit të tryezave ndërinstitucionale në lidhje me hartimin e akteve nënligjore që do të përcaktojnë autoritetet përgjegjëse dhe mënyra e mbrojtjes dhe ruajtjes së vendvarrimeve të identifikuar ose të dyshuara.

Angazhimit për procesin e digjitalizimit të dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit të mbledhura nga institucionet arkivore në vend në arkivin e vetëm të Autoritetit.

Angazhimit për evidentimin e të vrarëve apo të vdekurve në tentativë për të kaluar kufirin gjatë regjimit komunist, identifikimin e vendvarrimeve të mundshme të të zhdukurve në territorin administrativ të Kolonjës dhe vënien në mbrojtje dhe mbikëqyrje të posaçme, për t'i ruajtur nga tjetërsimi i mundshëm.

Verifikimit administrativ për gjetjen e eshtrave dhe qartësimin e fatit të të zhdukurve gjatë periudhës komuniste, si të burgosurve të ekzekutuar, të vrarë, apo të vdekur në burg, gjatë vuajtjes së dënimit në burgun e Spaçit.

Shkurtimin e afateve kohore të trajtimit të kërkesave studimore dhe medietike mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, si dhe garantimin e dublikatave të tyre te kërkuesi brenda afateve kohore të përcaktuara në aktet nënligjore.

Ndërtimin e platformës “Mësojmë nga e kaluara, burime arsimore të hapura 1944–1991”, një platformë interaktive në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, e cila parashikon të rrisë ndjeshmërinë e institucioneve përgjegjëse për rëndësinë që ka edukimi për qytetari demokratike, njohjen me veprimtarinë e ish-Sigurimit të Shtetit, por edhe me mbijetesën, qëndresën dhe solidaritetin e atyre që vuajtën në sajë të kësaj veprimtarie.

Kuvendi kërkon që Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit për vitin 2024 të angazhohet në këto drejtime:

1. Të vijojë angazhimin për qartësimin e fatit të të zhdukurve në komunizëm, në komunikimin me familjet, grupet e interesit, pushtetin lokal, organizatat ndërkombëtare dhe institucionet e ngarkuara për këtë qëllim.

2. Të vijojë angazhimin për krijimin e një baze të vetme të dhënash për personat e zhdukur dhe ta bëjë atë publike e të aksesueshme për publikun.

3. Të intensifikojë bashkëpunimin me institucionet kushtetuese dhe autoritetet publike për riverifikim të figurës së zyrtarëve të pajisur më parë me certifikatë pastërtie nga komisionet “Bezhani” e “Mezini”.

4. Të bashkëpunojë me KQZ-në për ndryshimet e nevojshme të kuadrit ligjor ekzistues lidhur me integritetin e zyrtarëve, Kodit Zgjedhor, apo ligjit për partitë politike në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe të angazhohet për verifikimin e të gjithë kandidatëve në zgjedhje.

5. Të intensifikojë bashkëpunimin me institucionet publike për marrjen e materialeve arkivore të ish-Sigurimit të Shtetit dhe dokumenteve arkivore sipas përkufizimit të nenit 3, pika 5, të ligjit

nr. 45/2015, i ndryshuar, si dhe t'i raportojë Kuvendit për të adresuar problematikat e hasura gjatë procesit.

6. Të angazhohet në përmirësimin e procedurave për ta bërë procesin e verifikimit të subjekteve lehtësisht të kuptueshëm për palët e interesuara dhe plotësisht të realizueshëm, si dhe të krijojë bazën e të dhënave me emrat e subjekteve të verifikuara, informacionet për strukturat operative ose bashkëpunëtorët e ish-Sigurimit të Shtetit.

7. Të rrisë aktivitetin ndërgjegjësues përmes përdorimit të medieve dhe formave të komunikimit virtual, me qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin për rolin e AIDSSH-së për informimin e individëve mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.

8. Të angazhohet për një marrëveshje bashkëpunimi me ministrin e Shtetit për Pushtetin Vendor me qëllim zbatimin korrekt të ligjit për kryerjen e procesit të verifikimit të figurës së personave që propozohen për dekorim, tituj nderi, apo propozimeve për emërtimin e hapësirave publike me emra personalitetesh, trajtimin e vendvarrimeve të dyshuara të ekzekutimeve, varreve të pashënuara, trajtimin e vendeve të kujtesës, strukturat e arsimit, bibliotekat e muzetë lokale.

Miraturar në datën 25.7.2024.

KRYETARE
Lindita Nikolla